



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA POGRADEK

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Ndërhyrje emergjente për rehabilitimin dhe stabilizimin e shkarjeve përgjatë Lumit të Vërdovës – Lagjja ish Ferma”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Punë ndërtimi 45000000-7;

Punime shtrimi dhe asfaltimi 45233222-1;

VLERA E FONDIT LIMIT: 49 583 333 (dyzet e nëntë milion e pesëqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH nga “Buxheti i Shtetit” me VKM Nr. 384, datë 28.05.2026 “Per miratimin e Projekteve fituese te financuara per Vitin 2026 nga fondi per parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqesive natyrore si dhe të autoritetit kontraktor për zbatimin e projekteve sipas Njësisë te Vetëqeverisjes vendore” si dhe pjesa e bashkefinancimit per objektin nga Bashkia Pogradec, miratuar me VKB nr. 74, date 09.06.2026 “Per një shtesë në VKB nr. 128, date 22.12.2025 “Per miratimin dhe detajimin e Buxhetit te Bashkise per Vitin 2026””, shkresës nr. 555/2 prot, Date 20.07.2026 së Ministrisë së Mbrojtjes, Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes civile, shkresën për rishpërndarje fondesh nga Drejtoria e Ekonomisë dhe e Menaxhimit Financiar fondi i parashikuar per likuidim në dy vite buxhetore:

- Viti 2026, vlere prej 17 850 000 (shtatëmbëdhjetë milion e tetëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa tvsh, nga Ministria e Financave.

- Viti 2027, vlere totale prej 31 733 333 (tridhjetë e një milion e shtatëqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa tvsh, nga te cilat 21 816 666 (njëzet e një milion e tetëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh nga Ministria e

Financave dhe vlere prej 9 916 667 (nëntë milion e nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh nga Bashkia Pogradec.

Në bazë të Nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar ; Nenit 2, pika 2/c si dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor, Bashkia Pogradec, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26 e 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/b, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024,2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe nenet 43 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj dhe është në përpjesëtim të drejtë me fondin limit të procedurës. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në mbështetje të Ligjit 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 64 Deklarata Tatimore; Ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje Ligjin nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2023, 2024,2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, të nenit 43, pika 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e balanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe bazuar në Ligjin nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar.

Kërkesa për paraqitjen e balanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025 dhe kesti i maturuar për vitin 2026 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Shënim: Ky kriter (2.2.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Pogradec, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Njësia e Prokurimit argumenton se pika 2.2.3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e Taksave Vendore" (i ndryshuar), Neni 5, gërma "c" ku citohet se: përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale".

2.3. Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë **jo më të vogël** se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

ose

- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është **jo më e vogël se** dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

-Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten:

1. Formularin e vleresimit sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
2. Kontratë
3. Situacionin përfundimtar;
4. Aktin e kolaudimit;

-Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten

1. Kontrate;
2. Situacionin përfundimtar;
3. Akt kolaudimi;
4. Fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore

-Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë gjithashtu edhe Kontraten e Bashkimit të operatoreve ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

Pika 2.3.1/a, plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

-Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë gjithashtu edhe Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor si dhe Miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së përllogaritur të kontratës, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku qartazi përcaktohet se: **“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.**

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Lidhur me dokumentacionin e kërkuar për vërtetimin e punëve të ngjashme janë kërkuar keto dokumenta në përputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku ndër të tjera përcaktohet se: **Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.**

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruar në organet tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.

Në kuader të vlerësimit të ofertave në mënyrë sa më të drejtë, duhet që në rastet e BOE apo Nenkontraktimit, vlerësimi i përvojës të mëparshme të vërtetohet me paraqitjen e kontratës së bashkëpunimit apo marrëveshjes së nenkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nenkontraktimit lëshuar nga Institucioni. Dokumenta keto të nevojshme për të vlerësuar lidhur me punët konkrete që ka kryer OE si anëtar i BOE, apo si nënkontraktor. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qene Nënkontraktor.

Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk mund të sjellë kufizim të pjesmarrjes së OE në tender as në mënyrë direkte dhe as në mënyrë indirekte.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore të sipërcituar dhe vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “*Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*”. Licenca duhet të përmbajë kategoritë e punimeve të kontratës si më poshtë:

PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

NP-1 A Punime gjurmimi në tokë.

NP-4 B Rruge, autostrada, mbikalime

N.P. 9 B Punime mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime

PUNIME SPECIALE NDERTIMI

N.S –1 A Punime për prishjen e ndërtimeve

N.S – 7 A Barriera dhe mbrojtje rrugore

N.S – 8 A Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri

NS- 18 A Punime topogjeodezike

Sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislationit në fuqi.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Operatorët e huaj duhet të plotësojnë kërkesat e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës sipas përcaktimeve më sipër.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe Vendim të

Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, gjithashtu Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi. Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

<i>Kategoria e kërkuar</i>	<i>Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës</i>	<i>Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</i>	<i>Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive</i>	<i>Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</i>
<u>Kategoria NP-1</u>	<i>Punime germimi</i>	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjerësi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet Skarifikim shtrese asfalti ekzistues me makineri Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km Transport element betoni dhe b/a me auto deri 30 km	<i>Niveli A</i>	<i>1 322 167 leke pa tvsh Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar 0- 20 milion lekë</i>
<u>Kategoria NP-4</u>	<i>Rruge,autostrada, mbikalime</i>	Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri(trotuar kunete dhe nen beton) Shtrese çakelli mbeturine kave t=10cm, perhapur e ngjeshur me makineri(nen shtresen e betonit)	<i>Niveli B</i>	<i>21 200 000 leke pa tvsh Vlera e parashikuar ne preventiv Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date</i>

		Shtrese stabilizant t=10cm Shtrese binderi me granil gur kave,8cm,me makineri Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 6cm, me makineri Shtrese betoni C 12/15(posht mureve) Struktura monolite betoni C 16/20(shtresa ne shtratin e lumit) Struktura te holla monolite betoni C 16/20, (KUNETA) Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 1 k katrama(tek urat) Hidroizolim me dy shtresa astar me baze cemento. Pergatitur nga dy komponente A+B		16.01.2008, i ndryshuar 21- 50 milion lekë
--	--	--	--	---

<u>Kategoria</u> <u>N.P. 9</u>	Punime mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime	Mure b/a t = 21-30cm, h ~ 4m C 16/20 Mure butobetoni C16/20 Soleta te plota b/a C 25/30, h~4 m(URAT) Trare e arkitrare b/a C20/25 h ~ 4m(URAT) Mur me blloqe betoni 20cm, deri - 3m, me LL.P. M-15 Brez b/a C 12/15 F.V pllaka betoni C 16/20, t=6 cm, mbi shtrese rere F.V. Hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm(per muret, shtresen e lumit dhe urat) F.V. Hekur betoni i zakonshem Ø > 12mm Ndertim drenazhi,mbushje me cakell prodhuar mak Gjeotekstil me gramature 500 g/m2 Ndertim Pusete kontrolli b/a,F1 m, h=2.0÷2.5 m + kapak gize Transport element betoni dhe b/a me auto deri 30 km F.V. Tub drenazhi Ø 150 mm Ndertim Pusete b/a, F1.0 m, h=1.0 ÷1.5 m Mbushje me gur kave Furnizim, vendosje tuba plastmasi ø 80 mm (per kullimin e ujrave te shiut ne muret e butobetonit dhe veshja e mureve te gurit)	Niveli B	29 704 747 leke pa tvsh <i>Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar 21- 50 milion lekë</i>
-----------------------------------	---	--	----------	--

<u>Kategoria</u> <i>N.S – 1A</i>	<i>Punime prishjen ndërtimeve</i>	Prishje soleta b/a Prishje shtresa betoni(Kuneta e rruges + shtresa te tjera oborret e banesave) Prishje mure beton/arme Prishje mur guri Prishje mure beton/arme Prishje mur blloqe betoni Prishje kollona, trare b/a Prishje mur tulle pa pastrim Prishje cati ekzistuese me tjegulla Heqje dyersh me kangjella metalike Prishje shtrese çakelli t = 15 cm, me makineri	<i>Niveli A</i>	2 587, 416 <i>leke pa tvsh</i> <i>Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar 0- 20 milion lekë</i>
<u>Kategoria</u> <i>N.S – 7A</i>	<i>Barriera dhe mbrojtje rrugore</i>	F.V. Guardrail- H2 anesore me 2 valez. ne 1 ane, W6 F.V. Waterstop tip RT 2000 10*20 & h/izolues, tip rapid cement, ne bashkimin e kampatave b/a	<i>Niveli A</i>	430 000 leke pa tvsh <i>Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar 0- 20 milion lekë</i>
<u>Kategoria</u> <i>NS-8</i>	Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri	Bordura trotuari 20x35cm te parapergatitura F V bordura betoni 15x30cm F.V. Konstruksiione metalike te thjeshta. F.V. Dyer metalike llamarine	<i>Niveli A</i>	1 469 990 leke pa tvsh <i>Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar 0- 20 milion lekë</i>

<u>Kategoria</u> <u>NS-18</u>	<i>Punime topogjeodezike</i>	(Kjo pike e licences përfshin ndihmën në përcaktimin e nivelit dhe formës së terrenit përmes matjeve topografike për të gjithë zerat në preventiv).	<i>Niveli A</i>	
----------------------------------	----------------------------------	---	-----------------	--

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për **3 (tre)** muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Kontratë pune e vlefshme;
- b) Diplomë.
- c) C.V (përkatëse)

Shënim: Ky kriter (2.3.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

2.3.4 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për muajin fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- 1 (një) Inxhinier Ndertimi
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Gjeodet / Topograf / Markshaidër
- 1 (një) Inxhinier Gjeoteknik

Shënim: Ky kriter (2.3.4) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi pika 2.3.3 dhe 2.3.4: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar sipas DST, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Referuar preventivi të Punimeve si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku është kërkuar:

NP-1, NP-4, NS-7 është e nevojshme prezenca e Inxhinierit të Ndërtimit si person përgjegjës për ndjekjen e punimeve të ndërtimit dhe siguron që ato të kryhen sipas standardeve dhe projekteve të miratuara.

Referuar preventivit të Punimeve si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku është kërkuar NS-18, është e nevojshme prezenca e Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder, pasi përcakton dhe monitoron matjet e terrenit dhe siguron saktësinë e punimeve topogjeodezike dhe çdo matje, pozicionim, rakordim në vendosje sipas plan-vendosjes që do të bëhet në funksion të objektit të prokurimit kërkon domosdoshmërisht praninë e këtij Inxhinieri. Lidhur me piken për Inxhinierin Gjeoteknik duke qenë se objekti përfshin ndërtimin e disa urave në afërsi të shtratit të lumit, kërkohej eksperiencë dhe ekspertizë gjeoteknike për vlerësimin e kushteve të terrenit, kapacitetit mbajtës të tokës, stabilitetit të themeleve dhe brigjeve, si dhe ndikimit të ujrave dhe gërryerjes së shtratit të lumit. Përfshirja e një inxhinieri gjeoteknik si kriter teknik është e domosdoshme për garantimin e sigurisë, qëndrueshmërisë dhe realizimit të saktë të veprës gjatë zbatimit të themeleve të urave. Përsa i përket inxhinierit Hidroteknik duke qenë se objekti përfshin ndërtimin e disa urave në afërsi të shtratit të lumit, kërkohej ekspertizë hidroteknike për vlerësimin e kushteve të rrjedhjes së ujit, prurjeve dhe niveleve të permbytjeve si dhe për përcaktimin e masave mbrojtëse ndaj erozionit dhe gërryerjes së shtratit të lumit. Përfshirja e një inxhinieri hidroteknik si kriter teknik është e nevojshme për të garantuar sigurinë dhe funksionalitetin e urave dhe të veprave rrugore në kushtet e ndryshimit të prurjeve dhe të niveleve të lumit.

Duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: *“drejtuesit ligjore dhe teknik të sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi”* si dhe pikës 2.1 ku citohet se *“drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit.*

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i shoqërisë duhet të jetë te përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të mos jenë të angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 *“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”*, pika 2 ku përcaktohet se: *“Papajftueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknik të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit”* dhe pika 2: *“elementët e licensës”* germa “c” ku citohet se: *“Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”*.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dipozitave ligjore në fuqi.

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet te disponoje Liçense te leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB) Kodi III.2.B (Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 *“Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”*, i ndryshuar, e shoqëruar me Aktin e Miratimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 *“Për lejet e mjedisit”* i ndryshuar, ku parashikohet se: *“leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji”*.

Në shtojcën 1/B është listuar edhe veprimtaria “Menaxhimi i mbetjeve”.

Në nenin 57/2 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 *“Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”*, i ndryshuar, parashikohet se: *“Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën **për transportin e mbetjeve**, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, pas miratimit të saj nga ministri”*.

Ndërkohë, sipas VKM nr. 538, datë 26.5.2009 *“Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”*: *“Veprimtaria*

e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republika e Shqipërisë”, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

- | | |
|---------------------------------|-------------|
| - Teknik ndertimi | 1 (nje) |
| - Specialiste betoni (betonues) | 5 (pese) |
| - Karpentier | 5 (pese) |
| - Hekurkthyes | 3 (nje) |
| - Asfaltoshtrues | 2 (dy) |
| - Saldator | 3 (tre) |
| - Pllakashtrues | 4 (kater) |
| - Murator/Suvatues | 2 (dy) |
| - Punonjes te thjeshte | 4 (kater) |
| - Shofer | 5 (pese) |
| - Manovratore | 6 (gjashte) |
- Për punonjesit shofere dhe manovratore, ofertuesi duhet të paraqesë:
- kontratën individuale të punës të vlefshme dhe dokumentacionin si më poshtë:
 - Shofere - Leje Drejtimi dhe Certifikatë e Aftësisë Profesionale (CAP)
 - Manovratore - Leje Drejtimi dhe Dëshmi e Aftësisë Profesionale (DAP)
 - Saldatore - Te pajisur/certifikuar me SSH/EN ISO 9606-1 për punime saldimi

Në rastin kur punonjësit *shofer/manovrator* janë të kontraktuar me kontratë pune, respektivisht për mjetet e marra me qira, nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

Shënim. Për puntorët e thjeshtë, duhet të disponojnë kontratë punë të vlefshme, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”. Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do

publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes që do të realizohen si dhe kohëzgjatjen e tyre.

Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të percaktuara në specifikimet teknike. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/deshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore.

Tekniku i ndertimit do të qendrojë gjatë gjithë kohës në objekt për të ndjekur ecurinë e punimeve, materialet e punës, makineritë, pajisjet si dhe mbarevajtjen e punëve.

Specialistët e betonit, Karpentierët, Hekurkthyes, specialistët e cilet nevojiten për të kryer të gjitha llojet e punimeve të betonit të cilat janë të specifikuara në preventivin e punimeve (mure betoni, mure butobetoni, mure betonarme, soleta të plota betonarme të urave, trare dhe arkitrare betonarme, brez betonarme, shtresa betoni C12/15, struktura monolite betoni, struktura të holla monolite betoni etj).

Asfaltoshtuesit nevojiten për të kryer punime për shtresa binderi me granil gur kave 8 cm me makineri si dhe shtresa binderi me granil gur kave 6 cm me makineri.

Saldatorët nevojiten për saldimin e dyerve metalike si dhe saldimin e konstruksioneve metalike në veper.

Pllakashtruesit nevojiten për shtrimin e pllaksave të trotuarit si dhe vendosjen e bordurave anesore.

Muratore/Suvatues nevojiten për të kryer punime suvatimi tek muret rrethuese tek banesat e planifikuara për tu kryer prishje tek rrethimet.

Punonjës të thjeshtë do të kryejnë punime prishje dhe transporti brenda kanierit si dhe për përhapjen e shtresave të ndryshme të stabilizantit, çakullit etj.

Shofere janë kërkuar 5 (autoveteshkarkuese, kamioncine, autobot, autobetoniere, autovinc, autobitumatrice, Damper, auto pompebetoni)

Manovratore janë kërkuar 6 (Eskavatore 2, Buldozer, Greider, Rrul me vibrim dhe rrul me kompresor, asfaltoshtuese, Makineri për vijeimin e rruges).

2.3.7 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre:

- 1 (një) punonjës me certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzola të Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".
- 1 (një) punonjës i certifikuar si Specialist për testimin e Performances së materialeve/produnkteve të Ndertimit / inxhinier materiale.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- Diplomë/certifikatë
- Kontratë Punë të vlefshme si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar , të nenit 7 të Ligjit 10237, datë 18.02.2010 *Për sigurinë dhe shëndetin në punë*“, sipas të cilit: *Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“*

Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DT, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësit të cilet janë të çertifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangin apo parandalojnë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi. Gjithashtu është e nevojshme për të siguruar kushte të sigurt pune për punëtorët dhe për të respektuar rregulloret e sigurisë.

Nga preventivi i punimeve rezulton se kontrata përfshin volume të konsiderueshme punimesh rrugore, ndër të cilat shtresa çakëlli, shtresa zhavorri, shtresa stabilizanti, shtresa binderi dhe shtresa asfaltobetoni. Këto zëra përbëjnë elementë kryesorë strukturorë të objektit të kontratës dhe ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë, performancën dhe jetëgjatësinë e investimit. Në specifikimet teknike të procedurës janë parashikuar detyrime të qarta për kontrollin e cilësisë së asfaltobetonit dhe betonit, marrjen e mostrave, kryerjen e provave laboratorike, verifikimin e treguesve fizikë dhe mekanikë, si dhe dokumentimin teknik të rezultateve të kontrollit. Në mënyrë të veçantë, specifikimet teknike parashikojnë kontroll të vazhdueshëm të cilësisë së prodhimit të asfaltobetonit dhe betonit, marrje mostrash për analiza laboratorike, kontroll të cilësisë së asfaltobetonit të shtruar dhe betonit të hedhur në vepër, si dhe mbajtjen e akteve teknike ku pasqyrohen të gjitha të dhënat e kontrollit me pamje, matje dhe prova laboratorike. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Kërkesa specifike e kërkuar jo domosdoshmërisht të përfshirë në liçensën e shoqërisë është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve. Operatori ekonomik duhet të disponojë kapacitete profesionale të mjaftueshme për monitorimin, ndjekjen dhe kontrollin e cilësisë së materialeve gjatë gjithë procesit të zbatimit të kontratës. Në këtë kuptim, disponimi i 1 (një) Specialisti për Testimin e Performancës së Materialeve/Produkteve të Ndërtimit/Inxhinier Materialeve ose Operatori Ekonomik duhet të paraqesë raporte testi laboratorike të lëshuara nga laborator të akredituar për kryerjen e testeve për materialet kryesore të ndërtimit (asfalt, beton), sipas kërkesave të projektit përbën një kërkesë proporcionale dhe të

nevojshme për garantimin e cilësisë së punimeve duke marrë në konsideratë natyrën e objektit të prokurimit dhe kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike.

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht **29 persona**, dokumentuar kjo me vertetimin e pageses se sigurimeve shoqerore dhe shendetesore nga administrata tatimore dhe listpagesat e Kontributeve te Sigurimeve Shoqerore, Shendetesore dhe Tatimit mbi te Ardhurat nga Punesimi per 3 muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.

***Shënim:** Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.*

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 77, pika 4, si dhe në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, neni 39, pika 5, germa “ç”, të cilat parashikojnë të drejtën e autoritetit kontraktor për të kërkuar prova mbi kapacitetet teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomikë, në masën e nevojshme dhe proporcionale me objektin e kontratës. Si dhe në mbështetje të Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, të VKM-së nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, date 26.10.2018), të VKM-së nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve”, si dhe të Udhëzimit nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, sipas të cilave fuqia punëtore përbën një nga elementët bazë të realizimit të punimeve të ndërtimit dhe të përllogaritjes së tyre. Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është të garantojë se operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore të nevojshme për realizimin e punimeve objekt prokurimi sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës, në përputhje me vëllimin, natyrën, kompleksitetin. Numri i kërkuar i punonjësve është përcaktuar bazuar në analizën e volumeve të punimeve, afatin e realizimit të kontratës dhe nevojën për organizimin e grupeve të punës që sigurojnë vijimësinë dhe cilësinë e zbatimit të punimeve. Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses Nga ana teknike argumentojmë se numri mesatar i punonjësve, prej gjithsej 29 punonjësish, është caktuar në bazë të llogaritjeve të zërave të punës dhe volumit përkatës të cdo zëri në preventiv si dhe në zbatim të grafikut të punimeve, punime të cilat duhet të përfundojnë brenda 6 muajve nga marrja ne dorezim e sheshit te ndertimit, mbështetur në legjislacion e sipërcituar. Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas së cilës: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në

këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

2.3.9 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Lloji i Makinerive	Sasia	Pronesia
Autoveteshkarkues me kapacitet mbajtes 15 deri 20 ton	Cope 1	ne pronesi ose me qira
Kamioncine me kapacitet mbajtes 3,5 deri ne 5 ton	Cope 1	ne pronesi ose me qira
Autovinc me kapacitet mbajtes 8 deri 10 ton	Cope 1	ne pronesi ose me qira
Eskavator me goma	Cope 2	ne pronesi ose me qira
Damper me goma me kapacitet mbsjtes 1 deri 4 ton	Cope 1	ne pronesi ose me qira
Buldozer	Cope 1	ne pronesi ose me qira
Greider	Cope 1	ne pronesi ose me qira
Autobetoniere	Cope 1	ne pronesi ose me qira
Autobitumatriçe	Cope 1	ne pronesi ose me qira
Asfaltoshtruese	Cope 1	ne pronesi ose me qira
Makineri per vijeimin e rruges	Cope 1	ne pronesi ose me qira
Rrul me vibrim ngjeshes	Cope 1	ne pronesi ose me qira
Rrul me kompresor	Cope 1	ne pronesi ose me qira
Autobot uji	Cope 1	ne pronesi ose me qira
Autopompe betoni	Cope 1	ne pronesi ose me qira
Vibrator Thellesie	Cope 2	ne pronesi ose me qira
Betoforma (armature, kallep) derrase	Cope 1	ne pronesi ose me qira

Makineri per vendosje Guardrail	Cope 1	ne pronesi ose me qira
Elektrosaldatrice	Cope 1	ne pronesi ose me qira
Gazogjen	Cope 1	ne pronesi ose me qira
Impiant (fabrike) prodhim betoni (shoqeruar me lejen mjedisore III.1.B)	Cope 1	ne pronesi ose me qira

Si deshmi per plotesimin e kesaj pike duhet te paraqiten dokumentat si më poshtë:

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, ne rast se mjeti është ne pronesi te paraqiten: certifikata e pronesise, leja e qarkullimit, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit dhe çertifikatë për transport mallrash brenda vendit per mjetet me kapacitet transportues mbi 1500 kg.

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, ne rast se mjeti është me qera te paraqiten: kontrata e qerese vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi, e shoqeruar me lejen e qarkullimit, certifikaten e pronesise, certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit dhe çertifikatë për transport mallrash brenda vendit, per mjetet me kapacitet transportues mbi 1500 kg.

-Per mjetet dhe pajisjet e tjera qe nuk shenohen ne regjistra publik ofertuesi duhet te paraqesë dokumente qe vertetojne pronesine e mjeteve/pajisjeve dhe ne rast se jane me qera duhet te kontrata e qerese vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi e shoqeruar me dokumentacionin qe verteton pronesine e tyre.

➤ Per fabriken e prodhimit te betonit:

Ne rast se është **ne pronesi** duhet te paraqiten dokumente qe vertetojne pronesine, planvendosjen e nyjes, lejen mjedisore (duhet te paraqitet leja mjedisore Kodi III.1B leshuar nga Qendra Kombetare e Licencimit ose leja mjedisore e leshuar nga Ministria e Mjedisit.)

Ne rast se fabrika e prodhimit te betonit **me qera** duhet te paraqitet kontrata e qerese, vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi, e shoqeruar me dokumente qe vertetojne pronesine e nyjes, planin e vendosjes te nyjes dhe lejen mjedisore (duhet te paraqitet leja mjedisore Kodi III.1B leshuar nga Qendra Kombetare e Licencimit ose leja mjedisore e leshuar nga Ministria e Mjedisit.)

Ne rast se nuk ka ne pronesi apo me qera fabrike te prodhimit te betonit duhet te paraqitet kontrata paraprake e furnizimit me prodhuesin, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, e shoqeruar me dokumente qe vertetojne pronesine e saj.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë

autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi i kritereve 2.3.8 dhe 2.3.9: Keto kritere u vendosen nga specialist i fushës i argumentuar ne procesverbalin e mbajtur prej tij date 22.06.2026 si me poshte: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe **nenit 39, pika 6/ç** ku përcaktohet se “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: **fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit**“ dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se „Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: **mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.**“

Me anë të këtyre kritereve kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin minimal të punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, është zbatuar legjislacioni i fushës, konkretisht VKM Nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim dhe Udhëzimit nr.2, datë 08.05.2003, “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit” dhe gjithashtu jam bazuar edhe në rekomandimin e APP Nr 1797/1 datë 10.03.2022 janë parashikuar orët e punës për secilin zë punimesh sipas tabelës bashkelidhur dhe bazuar edhe në afatin e përcaktuar në grafikun e punimeve është përcaktuar **numri minimal i punonjësve të domosdoshëm për realizimin e punimeve.**

Numri i fuqisë punëtore është llogaritur në baze të zberthimit të grafikut të punimeve, zberthimit të preventivit dhe natyrës së objektit, numri prej 29 personash përfshin personelin kryesor drejtues teknik dhe punëtorë të tjerë për llogaritje nga zberthimi i preventivit, grafikut të punimeve dhe natyrës së objektit.

Konkretisht nga llogaritjet e bera nga specialisti i fushës rezulton se:

Sasia totale e oreve të punës sipas manualit dhe analizave teknike për çdo zë të preventivit është **36 238 ore**. Llogaritja e numrit të punonjësve në varesi të oreve të punës dhe afatit të kontratës është si më poshtë:

<i>Totali orë pune + orë makineri</i>	36 238
<i>Ditë pune (orë pune/8)</i>	4530
<i>Specialiste+punetore per 6 muaj</i>	29

Argumentim: Lidhur me mjetet edhe pajisjet teknike:

Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës Ky kriter u vendos duke patur parasysh natyren dhe volumen e punimeve te parashikuara ne preventiv.

Gjithashtu bazuar ne nenin 28 të Udhezimit Nr.15, datë 24.7.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor” i ndryshuar, “Kamionët me kapacitet transportues nën 1500 kg nuk certifikohen për transport mallrash brenda vendit”.

Lloji i Makinerive	Sasia	Pronesia	Argumentimi
Autoveteshkarkues me kapacitet mbajtes 15 deri 20 ton	Cope 1	ne pronesi ose me qira	Kërkohet për realizimin e zërave “Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 3 km”, “Transport dheu me auto deri 3 km”, “Transport cakelli”, “Transport stabilizanti”, “Transport mbeturinash” etij si dhe për furnizimin me te gjitha materislet e ndertimit qe do te perdoren ne objekt. Sasia 1 cope me kapacitet mbajtes 15 deri 20ton justifikohet për të siguruar vazhdimësi pune ndërmjet gjurmimit, transportit dhe shtrimit të materialeve.
Kamioncine me kapacitet mbajtes 3,5 deri ne 5 ton	Cope 1	ne pronesi ose me qira	Kërkohet për transport materialesh në ambiente me akses më të kufizuar ose për mbështetje logjistike gjatë furnizimit të

			kantierit me materiale ndërtimi dhe largimit të dheut nga gërmimet si dhe për të afëruar materialet në vendin e punës.
Autovinc me kapacitet mbajtes 8 deri 10 ton	Cope 1	ne pronesi ose me qira	Kërkohet për realizimin e zërit “Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , në kanale gjerësi >2 m, tokë zak., kategoria III, me shkarkim në mjet” si dhe për ngarkimin e materialeve që do të dalin nga prishjet e mureve, të soletave në objekt tek autoveteshkarkuesja. Sasia 1 justifikohet për të siguruar vazhdimësi pune referuar zerave të preventivit dhe grafikut të punimeve.
Eskavator me goma	Cope 2	ne pronesi ose me qira	Kërkohet për realizimin e gërmimit të dheut, për prishjen e mureve të gurit të ndërtuara në shtratin e lumit si dhe pastrimin dhe gërmimin në shtratin e lumit
Damper me goma me kapacitet mbajtes 1 deri 4 ton			Mjet me kapacitet të vogël transporti i cili do të përdoret për transportimin e materialeve të ndryshme që do të përdoren në territorin e banesave si dhe në trotuare
Buldozer	Cope 1	ne pronesi ose me qira	Kërkohet për përhapjen ose grumbullimin e materialeve të nxjerra nga prishjet.
Greider	Cope 1	ne pronesi ose me qira	Kërkohet për profilimin, nivelimin dhe përhapjen e materialit në zërin “Mbushje me material të gërmuar në trupin e rrugës, përhapur e ngjeshur me makineri”, si dhe për realizimin e

			shtresës së cakullit dhe stabilizantit. Sasia 1 justifikohet për të siguruar vazhdimësi pune referuar zerave të preventivit dhe grafikut të punimeve
Autobetoniere	Cope 1	ne pronesi ose me qira	Garanton ruajtjen e cilësisë së betonit gjatë transportit nga nyja e betonit deri në vendin ku do të hidhet betoni
Autobitumatrice	Cope 1	ne pronesi ose me qira	Automjet në formë boti për mbajtjen e bitumit, i cili përdoret si shtresë e parë, si spërkatje me emulsion bituminoz përpara hedhjes së shtresave asfaltike.
Asfaltoshtruese	Cope 1	ne pronesi ose me qira	Makineri e cila ka si funksion derdhjen e asfaltit në rrugë dhe përhapjen e saj në të gjithë gjërësinë e rrugës. Kërkohej për realizimin e zërit “Shtresë asfalt miks t=6 cm”, për garantimin e shtrimit uniform të asfaltobetonit sipas parametrave teknikë të projektit. Numri 1 siguron vazhdimësi pune në fronte të ndryshme pune.
Makineri për vijeimin e rrugës	Cope 1	ne pronesi ose me qira	Përdoret për vijeimin e rrugës, në drejtim tërthor dhe gjatësor,
Rrul me vibrim ngjeshës	Cope 1	ne pronesi ose me qira	Rruli me vibrim ngjeshës përdoret për ngjeshjen e tabanit të rrugës, i cili ka arritur kuotën e kërkuar dhe ngjishet në mënyrë që të mos krijohen plasaritje dhe çarje gjatë hedhjes së shtresave të tjera të cakullit dhe stabilizantit .
Rrul me kompresor	Cope 1	ne pronesi ose me qira	Përdoret për ngjeshjen e shtresave asfaltike.

Autobot Uji	Cope 1	ne pronesi ose me qira	Kërkohet për lagjen e shtresave gjatë realizimit të mbushjeve dhe shtresave cakull dhe stabilizant, me qëllim arritjen e lagështisë optimale për ngjeshje sipas kërkesave teknike të zbatimit. Sasia 1 justifikohet për të siguruar vazhdimësi pune referuar zerave te preventivit dhe grafikut te punimeve
Autopompe betoni	Cope 1	ne pronesi ose me qira	Perdoret per hedhjen e betonit ne vepet meqenese pompa ka nje krah te gjate mbulon te dy llojet e punimeve te betonit qe do te hidhen ne te dy krahjet e lumit.
Makineri per vendosje Guard rail	Cope 1	ne pronesi ose me qira	Makineri e thjeshte qe perdoret per montimin e guard railve ne rrugen e shembur, barriera anesore te rruges.
Vibrator thellesie	Cope 2	ne pronesi ose me qira	Mjet qe perdoret per ngjeshjen e betonit qe hidhet ne veper
Impiant (fabrike) prodhim betoni (shoqeruar me lejen mjedisore III.1.B)	Cope 1	ne pronesi, me qira ose kontrate furnizimi	Nevojitet për sigurimin e materialit beton ne objekt, per vazhdimesine e punimeve dhe cilesine e betonit qe do te perdoret ne veper.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme:

2.4.1 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme:

- ISO 9001:2015 (*Sistemi i menaxhimit të cilesisë*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë ose (ekuivalent)

- ISO 14001-2015 ose standardin e perditesuar 14001-2026 (*Sistemi i menaxhimit të mjedisit*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë ose (ekuivalent).
- ISO 45001-2018 ose standardin e përditësuar 45001-2023 (*Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë ose (ekuivalent).
- ISO 3834-2:2021 (*Sistemi i menaxhimit të cilësisë në saldim*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë ose (ekuivalent).
- ISO 39001:2012 (*Sistemi i menaxhimit të sigurisë rrugore*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë ose (ekuivalent).
- *ISO 1090-1* (*Sistemi i menaxhimit të cilësisë për prodhimin dhe montimin e strukturave metalike*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë ose (ekuivalent)

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 10 gërma “a”- “e” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”,* si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.*

ISO 9001:2015 ose ekuivalente, është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me SSH/DIN/EN/CEI/UNI ISO 9001:2015 ose ekuivalente, me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ose ekuivalente, ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe

shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me SSH/DIN/EN/CEI/UNI ISO 14001:2015 ose ekuivalente, me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 ose 45001-2023 ose ekuivalente, është standard ndërkombëtar, i cili parashtrohet kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me SSH/DIN/EN/CEI/UNI ISO 45001-2018 ose ekuivalente, me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

ISO 39001:2012 ose ekuivalente, është standart ndërkombëtar, i cili përcakton kërkesat për sistemin e menaxhimit të Sigurisë së Qarkullimit Rrugor (RTS). AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 39001:2012 ose ekuivalente, me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të jetë në përputhje me sistemin e qarkullimit rrugor, si dhe të reduktojë apo përjashtojë rreziqet e humbjes së jetës dhe plagosjeve të rënda në aksidentet e qarkullimit rrugor. Duke marrë shkas dhe nga natyra e objektit të prokurimit (rehabilitim ure) ku mundësia për ngarkesën e trafikut rrugor është e lartë, me qëllim minimizimin e këtij risku, është e domosdoshme që Ofertuesit të jenë të pajisur me SSH/DIN/EN/CEI/UNI ISO 39001:2012 ose ekuivalente.

ISO 3834-2:2021 (Sistemi I menaxhimit të cilësisë në Saldim) është standart ndërkombëtar, i cili përcakton kërkesat për sistemin e menaxhimit të cilësisë në Saldim. Çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me EN-ISO 3834-2:2021 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të jetë në përputhje me sistemin e menaxhimit të cilësisë në Saldim. Duke marrë shkas dhe nga natyra e objektit të prokurimit (struktura metalike ku ka edhe saldime), me rritjen e cilësisë së ndertimit, është e domosdoshme që Ofertuesit të jenë të pajisur me EN-ISO 3834-2:2021/ekuivalente pasi materiali i dobët, i pasaktë dhe kushtet negative të saldimit krijojnë probleme serioze, të kushtueshme të cilat mund të çojnë në carje të nyjeve. AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Certifikatat e kërkuara është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Certifikatat e kërkuara janë në përputhje me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

ISO 1090-1 ose ekuivalente, është standard ndërkombëtar, i cili parashtrohet kërkesat për Sistemin e menaxhimit të cilësisë për prodhimin dhe montimin e strukturave metalike. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me këto ISO ose ekuivalente, me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të jetë në përputhje me sistemin e menaxhimit të cilësisë për prodhimin dhe montimin e strukturave metalike. Duke marrë shkas dhe nga natyra e objektit të prokurimit (rehabilitim ure) ku mundësia për gabime në strukturat metalike ka me tepër pasoja afatgjata.

Në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, cilësohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje”.

Për sa më lart, Njësia e Prokurimit, gjykon se, kjo kërkesë në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik duhet të përmbushet nga Shoqëria e cila referuar Marrëveshjes së Bashkëpunimit ka marrë përsipër të realizojë zerat elektrike të pasrashikuara sipas Preventivit.

AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara sipas pikës 12 gërma “a”- “e”, është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikatat e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve. Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Ne rast se dokumentet e mesipërme janë në gjuhë të huaj ato duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Për vetë natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarde që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës për sa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e

kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Dokumentacioni teknik ku përfshihen Specifikimet Teknike, Preventivi, Grafiku i Punimeve, Projekti, Relacioni I Argumentimit Teknik dhe Kapaciteti Teknik I kritereve të vecanta të kualifikimit për këtë objekt janë dorëzuar nga **Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit**, pranë Bashkisë Pogradec, në përputhje me detyrat e saj funksionale.

Specifikimet teknike shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b, dhe nenit 36 të LPP (e ndryshuar), si dhe Nenit 39, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit” i ndryshuar.

Në çdo rast nëse janë përmendur marka prodhimi, burim specifik apo proces i veçantë do të pranohen edhe ekuivalenti i tij/saj.

Gjate hartimit të specifikimeve teknike janë marrë në konsideratë kërkesat ligjore të fushës së planifikimit dhe zhvillimit të territorit si dhe normat perkatese të përcaktuara në aktet në ligjore në fuqi në fushën e ndërtimit.

Specifikimet teknike janë sipas materialit i cili është publikuar së bashku me dokumentat e tenderit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

NJESIA E PROKURIMIT